

**AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

NOAH TRADE

Sot, më datë 04.11.2023, personalisht:

Ada PRENDI, atesia Viktor, shtetase Shqiptare, lindur ne Mirdite me 23.12.1989 dhe baunuese ne Rr. Qamil GURANJAKU, NR.15, Tirane, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Përpilon këte akt themelimi të shoqërisë tregtare **NOAH TRADE sh.p.k**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqerinë Tregtare NOAH TRADE SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri NOAH TRADE SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësish me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit NOAH TRADE sh.p.k dhe ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Akomodim afatgjatë dhe të përkohshëm në dhoma të veçanta dhe të përbashkta, fjetore për studentë dhe individë të tjerë, fjetje dhe mëngjes (B&B).

NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Pjeter Budi, Nr. 4/891+2-13, Njesia Bashkiake nr 2, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.



NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mijë) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 7

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare NOAH TRADE sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Ada PRENDI, pjesemarrja me perqindje 100 %, 1 kuote, lloji i kontributit ne para 100.000 leke.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë te shoqërisë do të janë Zj. Ada PRENDI.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjispcionin në fuqi.

NENI 10

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.



NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Ada PRENDI

Ada Prendi af.

ff